



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR NXJERRJEN E REZULTATIT TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
BASHKISË TIRANË, QARKU TIRANË, NË ZGJEDHJET VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 11.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT:

Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë, në zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019.

BAZË LIGJORE:

Neni 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 123, neni 166, pika 1 të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN

Zona Zgjedhore Bashkia Tiranë territori i saj është i ndarë në 13 ZAZ. Në këtë rast KQZ-ja vërtifikon dhe nxjerr rezultatit për zonën zgjedhore, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Në përfundim të procesit të dorëzimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve dhe Tabelave të Rezultateve për çdo qendër votimi për Kryetarin e Bashkisë Tiranë nga të 13 KZAZ-të e kësaj



bashkie, KQZ, nxjerr rezultatin për këtë zonë zgjedhore, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, u krahasuan Tabelat e Rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga Grupet e Numërimit me Tabelat Përmbledhëse të Rezultatit të miratuara nga KZAZ nr.29, KZAZ nr.30, KZAZ nr.31, KZAZ nr.32, KZAZ nr.33, KZAZ nr.34, KZAZ nr.35, KZAZ nr.36, KZAZ nr.37, KZAZ nr.38, KZAZ nr.39, KZAZ nr.40, KZAZ nr.41 dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, rezultoi se:

- Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të miratuara nga KZAZ nr.29, KZAZ nr.30, KZAZ nr.31, KZAZ nr.32, KZAZ nr.33, KZAZ nr.34, KZAZ nr.35, KZAZ nr.36, KZAZ nr.37, KZAZ nr.38, KZAZ nr.39, KZAZ nr.40, dhe KZAZ nr.41, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të QV-ve që kanë këto ZAZ.

- Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhjet e shifrave si më poshtë:

ZAZ 29- Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Numri I Zgjedhësve që kanë votuar	2116	146	149	149

Tirane, ZAZ 30/ Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEMI
Fletë votimi të papërdorura	1625	454	0	442
Fletë votimi të papërdorura	2060	160	0	0
Fletë të demtuara	2060	0	0	160
Fletë votimi të hedhura gabim	2081	1	0	0

ZAZ 32 Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Vota të pavlefshme	1741	17	20	20
Flete Votimi të demtuara	1735	0	297	297
Numri I zgjedhesve që kane votuar	17271	265	365	365

ZAZ 33 - Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Nr Zgjedhësve që kane votuar	1752	169	168	168
Flete votimi të paperdorura	17711	343	340	340



ZAZ 34- Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Vota të pavlefshme	18021	7	8	8

ZAZ 35 - Kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Fletë votimi të papërdorura	1818	540	54	54
Vota të vlefshme	1821	227	226	226
Flete v.te gjetura ne kuti	1825	0	127	127
Vota të vlefshme	1825	127	111	111
Femra	1835	0	55	55
Femra	1837	60	6	6

ZAZ 36 kryetar	QV	GN	TPR	SISTEM
Numri I zgjedhesve qe kane votuar	18801	148	146	146

KQZ do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë, me shifrat e korigjuara, mbështetur në tabelat e rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore dhe tabelat origjinale të rezultateve të çdo qendre votimi të kësaj bashkie, të plotësuar nga grupi i numërimit të votave, si dhe të shpall fitues kandidatin për Kryetar Bashkia Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 21, pika 7, neni 23, pika 1, germa "a" nenin 123 dhe nenit 166, pika 1, të ligjit Nr.10019 datë 29.12.2009 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të shpallë fitues për Kryetar të Bashkisë Tiranë, z. Erion Luan Veliaj, të propozuar nga Aleanca për Shqipërinë Europiane.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

